



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 11, Datë 08/02/2013

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a) dhe nenin 33 të Ligjit Nr. 10021/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar ankesën e bërë nga Ambasada PINK/LGBT PRO Shqipëri me Nr. Regjistri 39, datë 08.11.2012, ku ndër Fakultetit të Mjekësisë dhe Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, në të cilën pretendohet se tekstet universitare diskriminojnë dhe paragjykojnë hapur komunitetin LGBT në Shqipëri.

Sipas ankesës së sipërpërmendur, Ambasada PINK/LGBT PRO Shqipëri pretendon se diskriminimi i komunitetit LGBT konsiston në faktin se në tekstet akademike të miratuara nga Katedrat përkatëse përdoren terma dhe informacione diskriminuese, jo shkencore dhe fyese për komunitetin LGBT. Po sipas kësaj ankese Ambasada PINK kërkon nga Komisioneri heqjen nga tregu apo modifikimin e tekstit "Mjekësi Ligjore" me autorë, Prof.Dr. [] dhe Prof.Dr. [].

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën Nr. 441 prot, datë 09.11.2012 u njoftuan subjektet ndaj të cilëve është bërë ankesë duke vënë në dijeni palët për fillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesës.
- Me shkresën Nr. 441/2 prot, datë 13.11.2012 subjekteve kundër të cilëve është bërë ankesa ju kërkua që të paraqesin parashtrime me shkrim në përgjigje të ankesës së bërë.
- Me shkresën Nr. 1495/4 prot, datë 19.11.2012, Fakulteti i Drejtësisë i është drejtuar Komisionerit me informacionin e kërkuar në të cilën sqarohet se: "lënda "Mjekësi Ligjore" për shkak të specifikës së natyrës mjekësore të saj ofrohet nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore pranë Fakultetit të Mjekësisë. Po kështu dhe programi mësimor i kësaj lënde detyrimisht vjen i miratuar prej këtij fakulteti. Lënda "Mjekësi Ligjore" në Fakultetin e Drejtësisë, për vitin akademik 2010-2011 është zhvilluar vetëm në sistemin



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

me kohë të pjesshme, cikli i studimeve Bachelor në Drejtësi, ndërsa për vitin akademik 2011-2012, kjo lëndë nuk është zhvilluar sepse nuk është zgjedhur nga studentët (si lëndë me zgjedhje)”.

Bashkëngjitur shkresës u dorëzuar dhe këto dokumente: - Shkresë nr. 1495/2, datë 14.11.2012 e Fakultetit të Drejtësisë, - Programi Mësimor Cikli i Parë, Mjekësi Ligjore, - Programi Mësimor i lëndës Shkenca Forense, Cikli i Studimeve Master Profesional në Drejtësi, - Plani Mësimor për Programin e Studimit Master Profesional, - Programi i Lëndës “Shkenca Forense”, - Plani Mësimor i Studimit “Master i Shkencave në Shkencat Penale”, - Programi Mësimor i lëndës Mjekësi Ligjore për ciklin e studimeve Doktor në Shkencat Juridiko-Penale, - Programi i studimit në Ciklin e Doktoraturës.

- Më datë 21.12.2012 nxirret Urdhri Nr. 60, “Për kryerjen e inspektimit në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës”.
- Me shkresën Nr. 541/1 Prot, datë 21.12.2012 njoftohet Fakulteti i Mjekësisë Tiranë për kryerjen e inspektimit me datë 26.12.2012.

Objekti i këtij inspektimi ishte:

- Njohja me Planin Mësimor dhe Programet Mësimore të lëndës Mjekësi Ligjore të Ciklit të Parë të Dytë dhe Tretë të studimeve.
- Kopje të rregullores së brendshme të Fakultetit të Mjekësisë
- Procedurën e ndjekur për miratimin e Planit Mësimor, Programit Mësimor dhe Programit të Lëndës Mjekësi Ligjore për vitin shkollor 2012-2013.
- Inspektim në bibliotekën e fakultetit.

Me datë 26.12.2012, ora 12.25, u realizua inspektimi pranë Fakultetit të Mjekësisë. Nga ana e Fakultetit të Mjekësisë ishte i pranishëm Dekani i këtij Fakulteti z. ¹

Gjatë inspektimit nga ana e inspektorëve u kërkuar të njiheshin me dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar në urdhërin e inspektimit. Në përgjigje të kësaj kërkesë z. ¹ janoi se: “kishte pak kohë që ishte në pozicionin e Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë dhe se nuk ka pasur mundësi për arsye kohe që të kthejë përgjigje Komisionerit, por dokumentacionet e kërkuara në Urdhërin e inspektimit do ti vërë në dijeni të Komisionerit pasi të konsultohet me stafin”.¹

- Me datë 14.12.2012, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka dhënë Vendimin Nr. 27, për autorët e tekstit “Mjekësia Ligjore” Prof.Dr. ¹ dhe Prof.Dr. ² të cilin ka **konstatuar diskriminim** përmes përmbajtjes së tekstit, për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.
- Me shkresën Nr. 1749/2 prot, datë 28.12.2012, Fakulteti i Mjekësisë, njofton Komisionerin me veprimet e ndërmarra në zbatim të Vendimit Nr. 27, datë 14.12.2012.

¹ Referuar proces verbalit të inspektimit administrativ, datë 26.12.2012



- Me shkresën Nr. 40/1 Prot, datë 10.01.2013, Komisioneri i është drejtuar Fakultetit të Mjekësisë në të cilën sqarohet se Vendimi Nr. 27, datë 14.12.2012 i është drejtuar autorëve të librit “Mjekësia Ligjore” dhe se detyrimi për zbatimin e këtij vendimi është përgjegjësi individuale e z dhe 7 ndërsa nga ana e Fakultetit kërkohet informacioni i kërkuar me shkresën Nr. 441/2, datë 13.11.2012.
- Më shkresën Nr. 60/1, datë 22.01.2013, Fakulteti i Mjekësisë ka dërguar këto dokumente: - Vendim Nr. 7, datë 01.10.2012 të Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë, - Vendim Nr. 8, datë 05.12.2012 të këshillit të Fakultetit të Mjekësisë, - Planin Mësimor Viti VI, Master në Mjekësi 2012-2013, - Programi i Integruar i Nivelit të Dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, - Rregullore e Universitetit të Tiranës.

Gjatë shqyrtimit të dokumenteve të grumbulluara, Komisioneri,

KONSTATON:

Në Fakultetin e Mjekësisë, lënda “Mjekësia Ligjore” zhvillohet në Programin e Integruar të Nivelit të Dytë, viti i VI i studimeve, program ky i miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 01.10.2012 të Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë.

Në Fakultetin e Drejtësisë, lënda “Mjekësi Ligjore” zhvillohet në vitin e III të Ciklit të Parë të studimeve. Lënda “Shkenca Forense” zhvillohet në Ciklin e Studimeve Pasuniversitare, Master Profesional në “E Drejtë Penale”, Master i Shkencave në Shkencat Penale (sistemi me kohë të plotë) si dhe lënda Mjekësi Ligjore në Ciklin e Tretë të Studimit (Doktoratura).

Komisioneri vëren se procedura e miratimit të programit të studimit dhe hartimit të kurrikulave mbështetet në: Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 25/2. “Programet e studimit hartohen nga vetë institucionet dhe miratohen në senatet e tyre akademike”, Statutin e Universitetit të Tiranës, miratuar më datë 16.12.2009, PJESA E TRETË, Organizimi i Studimeve, Neni 48, paragrafi i tretë: “Programet e studimeve në UT propozohen nga departamentet e fakulteteve dhe këshilli i fakultetit ia paraqet ato për miratim Senatit Akademik”, si dhe Rregullores së Universitetit të Tiranës, miratuar me Vendimin nr. 5, datë 12.04.2010 të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës, Neni 23/1, Përgjegjësi i Departamentit: “Drejton punën për hartimin e kurrikulave për të gjitha ciklet e studimit të lëndëve që mbulon departamenti, planeve mësimore dhe ndjek zbatimin e tyre”, dhe Neni 24/1, Përgjegjësi i grupit mësimor e kërkimor: “Organizon hartimin e kurrikulave të disiplinave që mbulon grupi dhe i paraqet në departament për diskutim”.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10021/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, si dhe Rekomandimit CM/Rec(2010)5 paragrafi



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
 (Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
 Tel: +355 4 2431078
 Fax: +355 4 2431077
 e-mail: info@kmd.al
 web: www.kmd.al

32 të Këshillit të Ministrave për shtetet anëtare lidhur me masat për të luftuar diskriminimin për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese, sidomos për sa i përket komunitetit LGBT, në Shqipëri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 parashikohet objekti i këtij ligji, duke sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*. Orientimi seksual dhe identiteti gjinor, janë shkaqe të cilat gëzojnë mbrojtje nga ligji dhe bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkelje që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Bazuar në nenin 17/1/c të ligjit nr. 10221/2010 *mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit, ndaloheq çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) përmbajtjen e parimeve dhe kritereve të veprimitarisë arsimore, duke përfshirë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies*.

Shqipëria si vend anëtar i Këshillit të Evropës, duhet të marrë masa dhe për zbatimin e pikës VI të Rekomandimit të Këshillit të Ministrave të KiE, CM/REC(2010)5, ku trajtohen çështje mbi arsimin, në të cilin përcaktohet se: *“Duke marrë parasysh mbi të gjitha interesat e fëmijës, duhet të merren masat e duhura për këtë çështje në të gjitha nivelet për të nxitur tolerancën dhe respektin e ndërsjellët në shkolla, pavarësisht orientimit seksual apo identitetit gjinor. Kjo duhet të përfshijë sigurimin e informacionit objektiv në lidhje me orientimin seksual dhe identitetin gjinor, për shembull në kurrikulat shkollore dhe materialeve arsimore, si dhe sigurimin e nxënësve dhe studentëve me informacionin e nevojshëm, mbrojtjen dhe mbështetjen për të mundësuar që ata të jetojnë në përputhje me orientimin e tyre seksual dhe identitetit gjinor”*.²

Me shkresën 1749/2 prot, datë 28.12.2012, Fakulteti i Mjekësisë njofton Komisionerin se: *“në lidhje me ankesën e Ambasadës PINK/LGBT, u vendos që në kopjet e mbetura të këtij teksti në Fakultetin e Mjekësisë si dhe në kopjet e bibliotekës të po këtij fakulteti, që do përdoren tani e tutje nga studentët, të hiqen faqet 141 dhe 142 që trajtojnë këtë çështje. Informacioni korrekt do të vazhdojë t’u jepet studentëve në leksionet e zhvilluara”*.

Në Relacionin datë 04.02.2013 të hartuar nga, Prof.Dr. _____ dhe Prof.J _____ zotuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në zbatim të Vendimit nr. 27. Datë 14.12.2012, informojnë se: *“Shqetësimi juaj është i drejtë dhe këtë e kemi shprehur në relacionet përkatëse që u kemi dërguar Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë dhe Mjekësisë, ku kemi sugjeruar rrugët e*

² Përkthim i Komisionerit



kapërcimit të këtij problemi. Për të korigjuar këtë difekt, ne kemi tërhequr ato pak kopje që kishin mbetur në librarinë universitare si dhe kemi bërë modifikimet përkatëse në paragrafet rreth homoseksualitetit, duke i vendosur në fund të librit nën termin Korigjim (kopjet që disponohen nga Biblioteka Kombëtare, ajo e Fakultetit të Drejtësisë dhe Mjekësisë). Me miratim të Këshillit Botues, jemi duke punuar për ribotimin tërësor të tekstit, dhe deri në përfundim studentët do të punojnë me leksione të shkruara duke përfshirë dhe kapitullin e përmirësuar rreth problemeve të Seksologjisë Ligjore”.

Komisioneri vlerëson se me reagimet dhe veprimet e autorëve të librit dhe Fakulteteve të Mjekësisë dhe Drejtësisë u arrit dhe qëllimi për të cilin është nisur ky hetim në drejtim të modifikimit të librit “Mjekësia Ligjore” si dhe sensibilizimit dhe ndërgjegjësimin të stafit akademik të Fakultetit të Mjekësisë dhe Drejtësisë mbi të drejtat e komunitetit LGBT.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, geramat a,c, nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

- Ndërprerjen e procedurave hetimore dhe pushimin e çështjes.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al